



Funded by  
the European Union

# Kompensimi i dëmit nga administrata publike, me fokus në veprimtarinë policore dhe inspektimet

Dhjetor 2024



GROUP FOR LEGAL  
AND POLITICAL  
STUDIES



GROUP FOR LEGAL  
AND POLITICAL  
STUDIES

---

# Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Grupi për Studime Juridike dhe Politike është një organizatë e pavarur, jopartiake dhe jofitimprurëse e politikave publike me seli në Prishtinë, Kosovë. Misioni ynë është të kryejmë kërkime të besueshme të politikave në fushat e politikës, ligjit dhe ekonomisë dhe të shtyjme përpara zgjidhjet e politikave që adresojnë dështimet dhe/ose trajtojnë problemet në fushat e politikave në fjalë.

# **Kompensimi i dëmit nga administrata publike, me fokus në veprimtarinë policore dhe inspektimet**

Dhjetor 2024

© Group for Legal and Political Studies, dhjetor 2024.

Ky publikim është financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e GLPS dhe nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Group for Legal and Political Studies  
“Rexhep Luci” str. 16/1  
Prishtina 10 000, Kosovo  
Website: [www.legalpoliticalstudies.org](http://www.legalpoliticalstudies.org)  
E-mail: [office@legalpoliticalstudies.org](mailto:office@legalpoliticalstudies.org)  
Tel/fax.: +381 38 234 456

## I. Hyrje

Kompensimi i dëmit nga administrata publike përbën një element themelor të qeverisjes së mirë dhe një tregues kryesor të sundimit të ligjit. Ai siguron mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe forcon përgjegjësinë e institucioneve publike. Në Kosovë, kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme për shkak të boshllëqeve sistematike në kuadrin ligjor, zbatimit të kufizuar praktik dhe mungesës së një ligji horizontal që rregullon përgjegjësinë e administratës publike në mënyrë të detajuar dhe koherente. Si rezultat, qytetarët dhe bizneset shpesh përballen me pengesa ligjore dhe procedurale në kërkimin e kompensimit të drejtë për dëmet e shkaktuara nga veprimet ose mosveprimet administrative.

Ky raport fokusohet në dy fusha kritike: Policia e Kosovës dhe inspektoratet. Këto sektorë janë përzgjedhur për shkak të ndërveprimeve të shpeshta me qytetarët dhe rolit të tyre në trajtimin e dëmeve administrative. Kuadri ligjor që rregullon Policinë e Kosovës është relativisht i avancuar, duke përfshirë përgjegjësinë objektive të shtetit dhe përgjegjësinë subjektive të zyrtarëve të policisë. Megjithatë, procedurat komplekse dhe burokratike shpesh vonojnë kompensimin efektiv dhe të shpejtë. Në të kundërt, përgjegjësia e inspektorateve mbetet e rregulluar në mënyrë të pamjaftueshme, pa dispozita ligjore specifike që adresojnë dëmet e shkaktuara gjatë inspektimeve. Kjo krijon pasiguri ligjore dhe lë proceset gjyqësore si mjetin e vetëm për kompensim, duke ngarkuar më tej gjykatat dhe duke kufizuar qasjen në drejtësi.

Raporti analizon kuadrin aktual ligjor, duke përfshirë Kushtetutën, Ligjin për Policinë, Ligjin për Inspektimet, Ligjin për Konfliktet Administrative dhe Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Ndërsa këto ligje ofrojnë një bazë për kompensimin e dëmeve, mbeten boshllëqe në zbatim dhe rregullim. Duke analizuar këto sfida, raporti nënvizon nevojën për reforma legjislative dhe përmirësime procedurale. Ai thekson rëndësinë e krijimit të një ligji horizontal për të rregulluar përgjegjësinë e administratës publike në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Për më tepër, ai ofron rekomandime të synuara për të thjeshtuar mekanizmat e kompensimit, për të reduktuar pasigurinë ligjore dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi të drejtën për të kërkuar kompensim. Edhe pse dëmet administrative mund të duken financiarisht të vogla, zgjidhja e tyre është jetike për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve, për të forcuar besimin në institucionet publike dhe për të garantuar sigurinë juridike.

## II. Përmbledhje Ekzekutive

Ky dokument trajton përgjegjësinë e administratës publike në Kosovë për kompensimin e dëmeve, me fokus të veçantë në veprimtarinë e Policisë së Kosovës dhe inspektorateve. Duke trajtuar aspektet ligjore dhe praktike, dokumenti thekson rëndësinë e kompensimit të dëmeve si një mekanizëm për të garantuar drejtësi dhe për të mbrojtur interesat e qytetarëve.

Në veprimtarinë policore, dokumenti vë në pah dispozitat që përcaktojnë përgjegjësinë objektive të shtetit dhe detyrimin e zyrtarëve policorë për të raportuar dëmet e shkaktuara. Po ashtu, analizohet roli i inspektorateve dhe mungesa e një kornize të qartë për përgjegjësinë e tyre subjektive. Në këtë kontekst, identifikohen mangësitë ligjore, si mungesa e një ligji horizontal për kompensimin e dëmeve nga administrata publike dhe procedurat e mangëta për trajtimin e kërkesave për kompensimin e dëmit.

Rekomandimet përfshijnë vendosjen e kornizës së plotë ligjore për përgjegjësinë e institucioneve të administratës publike në kompensimin e dëmit, trajnimin e stafit, fuqizimin e komisioneve për vlerësimin e dëmeve dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat e tyre. Gjithashtu,

sugjerohet zbatimi efektiv i Ligjit për Konfliktet Administrative dhe rishikimi i legjislacionit për inspektoratet për të përfshirë dispozita më të qarta mbi kompensimin e dëmeve.

Dokumenti përfundon duke theksuar rëndësinë e përgjegjësisë dhe transparencës së administratës publike në trajtimin e kërkesave për kompensim, si një hap drejt forcimit të besimit publik dhe garantimit të drejtësisë për të gjithë qytetarët.

### **III. Përgjegjësia e Administratës Publike në kompensimin e dëmeve**

Përgjegjësia e Administratës Publike në kompensimin e dëmit është segment i administrimit të mirë fillimisht por edhe segment i shtetit demokratik dhe sundimit të ligjit.

Administrimi i mirë<sup>1</sup>, si një standard i njohur në gjithë Evropën ku kërkon që administrata publike të veprojë në mënyrë të paanshme, transparente dhe efektive. Përgjegjësia për kompensimin e dëmeve është një tregues i qartë i një administrimi të mirë, duke garantuar se administrata pranon gabimet e saj dhe merr masa për t'i adresuar ato në mënyrë të drejtë dhe transparente. Ky proces ndihmon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike dhe forcon besimin e qytetarëve në institucionet publike.

Përgjegjësia e administratës publike në kompensimin e dëmit është një shtyllë e rëndësishme e shtetit demokratik, duke pasqyruar angazhimin për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve dhe për të siguruar një qeverisje të bazuar në sundimin e ligjit dhe administrimin e mirë. Ky koncept shpreh detyrimin e administratës për të mbajtur llogari për pasojat e veprimeve apo mosveprimeve të saj dhe për të garantuar kompensim të drejtë për dëmet e shkaktuara.

Në një shtet demokratik, administrata publike është e thirrur të veprojë në interes të qytetarëve, duke respektuar të drejtat e tyre themelore dhe duke qenë gjithmonë e kufizuar nga ligji. Parimi i sundimit të ligjit garanton se asnjë individ apo institucion, përfshirë administratën publike, nuk është mbi ligjin. Përgjegjësia për kompensim të dëmit është një shprehje e këtij parimi, duke siguruar një rrugë efektive për qytetarët që të kërkojnë drejtësi kur bien viktimë e veprimeve të paligjshme apo të papërgjegjshme të administratës.

Kjo përgjegjësi nuk është vetëm një mekanizëm juridik, por edhe një masë parandaluese që ndihmon administratën të veprojë me kujdes dhe efikasitet, duke minimizuar rrezikun e dëmtimit të qytetarëve apo interesave të tyre ligjshme.

Është esencial dallimi i kompensimit të dëmit në të drejtën publike dhe drejtën private sepse ka një ngatërresë që i bëhet këtij instituti juridik në praktikë.

Në të drejtën publike, dëmi shkaktohet nga veprimet ose mosveprimet e organeve shtetërore ose zyrtarëve publikë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre që i janë dhënë përmes autorizimeve publike të dhëna me ligj. Përgjegjësia e shtetit bazohet në detyrimin për të garantuar të drejtat dhe liritë e individëve dhe për të kompensuar dëmet që rezultojnë nga veprimet e paligjshme ose të gabueshme të administratës publike. Për këtë qëllim shteti duhet të miratoj legjislacionin të posaçëm që parashikon kompensimit të dëmit në nivelin e administratës publike dhe atë nga buxheti i secilit organ publik. Në këtë rast, shteti vepron si garantues i përmbushjes së interesit

---

<sup>1</sup> Administrimi i mirë për herë të parë përmendet dhe rregullohet në Kartën për të drejtat themelore të Bashkimit Evropian, i qasshëm në: [https://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text\\_en.pdf](https://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf)

publik por edhe i të drejtave të personave duke parashikuar edhe kompensimin e dëmit në nivel të organit publik që ka shkaktuar dëmin.

Në të drejtën private, dëmi lind nga marrëdhëniet ndërmjet personave (fizik dhe juridik) pa përfshirjen e drejtpërdrejtë të shtetit si palë, përjashtimisht kur shteti vepron sipas drejtës private pra merr përgjegjësi kontraktore (zakonisht përmes prokurimit publik). Përgjegjësia lidhet kryesisht me mosrespektimin e marrëveshjeve kontraktuale ose me dëme të shkaktuara jashtë kontratës. Qëllimi i kompensimit është të rivendosë palën e dëmtuar në gjendjen që do të kishte qenë nëse dëmi nuk do të kishte ndodhur. Procedurat për zgjidhjen e këtyre rasteve zakonisht realizohen përmes marrëveshjeve ndërmjet palëve dhe nëse kjo nuk arrihet përmes padive civile në gjykatën civil.

Dallimi tjetër ka të bëjë sa i përket gjyqimit të rasteve për kompensimin e dëmit. Kur dëmi shkaktohet nga administrata publike ndaj personave pala mund të filloj konflikt administrativ në gjykatën administrative ndërsa kur dëmi shkaktohet kur palët janë personat fizik dhe juridik, kontesti fillohet përmes padisë në gjykatën e cila gjykon kontestet civile.

#### **IV. Pse kompensimi i dëmit duhet të bëhet nga administrata publike?**

Kompensimi i dëmit nga administrata publike është një mekanizëm i rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave në mënyrë të plotë dhe efikase pa pasur nevojë të hapen procese gjyqësore. Kompensimi i dëmit është i domosdoshëm të bëhet brenda vetë administratës, pasi ofron një mënyrë më të shpejtë dhe më të thjeshtë për të trajtuar kërkesat për dëmet e shkaktuara nga veprimet ose mosveprimet e saj. Duke vepruar kështu, shmangen procedurat e gjata dhe shpesh të kushtueshme gjyqësore, të cilat mund të rëndojnë si qytetarët ashtu edhe sistemin gjyqësor.

Administrata publike ka përgjegjësinë të ushtroj autorizimet publike por të njohë edhe gabimet e saj dhe të korrigjojë pasojat e tyre përmes kompensimit të drejtë. Ky mekanizëm jo vetëm që ndihmon qytetarët të rikthehen në gjendjen e mëparshme, por edhe forcon përgjegjësinë e institucioneve publike. Për më tepër, një qasje e tillë kontribuon në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj administratës, duke treguar se ajo është e gatshme të përgjigjet për veprimet e saj dhe të mbrojë interesat e tyre.

Në nivel evropian, nga parimet më kryesore të Administratës Publike është edhe parimi nr:17<sup>2</sup> i cili përcakton “E drejta për administratë të mirë ruhet nëpërmjet procedurës administrative, shqyrtimit gjyqësor dhe përgjegjësisë publike”. Ky parim pastaj ka dy nën parime të cilat i dedikohen pikërisht kompensimit të dëmit nga administrata publike.

Nën parimi në pikën h<sup>3</sup>, përcakton “Individët dhe personat juridikë shpërblehen dhe kompensohen në mënyrë të drejtë për dëmet e shkaktuara nga shkeljet e atyre që kanë autoritetin publik”. Ky nën parim thekson të drejtën e individëve dhe personave juridikë për të marrë shpërblim të drejtë kur autoritetet publike shkaktojnë dëm përmes veprimeve ose mosveprimeve të tyre. Nëse interpretohet më tej administrata publike ka detyrimin për të

---

<sup>2</sup> SIGMA/OECD. Parimet e Administratës Publike, Edicioni i vitit 2023, fq.31,

<https://www.sigmaxweb.org/publications/Principles-of-Public-Administration-2023-edition-ALB.pdf>

<sup>3</sup> Ibid,

kompensuar në mënyrë të drejtë dhe proporcionale, duke u siguruar që personat që kanë pësuar dëme të rikthehen në gjendjen që do të kishin qenë nëse dëmi nuk do të kishte ndodhur. Kjo përfshin jo vetëm kompensimin e dëmit financiar, por edhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme, si kërkim faljeje zyrtare ose rivendosje të të drejtave të shkelura.

Nën parimi tjetër i përcaktuar në pikën i<sup>4</sup>., thekson “Administrata publike analizon shkaqet e pagesave të kompensimit dhe merr masa për të mësuar nga gabimet për të shmangur ose minimizuar gabime të ngjashme në të ardhmen”. Ky nën parim vë theksin tek roli proaktiv i administratës publike e cila kur detyrohet të kompensojë dëmet, ajo duhet të shqyrtojë shkaqet që çuan në gabimet përkatëse dhe të nxjerrë mësim prej tyre. Pra qëllimi është që administrata të mos ndalet vetëm te kompensimi, por të adresojë në mënyrë sistematike arsyet që çuan në shkelje ose gabime. Kjo mund të përfshijë ndryshimin ligjore e procedurale por edhe trajnimin e stafit e trajnimit të stafit në këtë aspekt.

Kompensimi i dëmit nga administrata publike si aspekt i administrimit të mirë mbetet vetëm një mundësi shtesë për personat. Megjithatë, është e rëndësishme që të ruhet gjithmonë e drejta për t’iu drejtuar gjykatës nëse procesi administrativ nuk garanton një zgjidhje të drejtë dhe të paanshme, si e drejtë kushtetuese kjo. Ky dualitet mes mekanizmave administrativë dhe gjyqësorë siguron një balancë midis efikasitetit dhe mbrojtjes së interesit të përgjithshëm por edhe drejtave subjektive të personave kur të njëjtat cenohen nga ushtrimi i autoritetit publik.

Duke ditur rëndësinë për interesin publik por edhe autorizimet e mëdha që kanë, si shembuj të përzgjedhur janë marrë Policia e Kosovës dhe inspektoratet.

## **V. Kompensimi i dëmit nga Policia e Kosovës**

Gjatë ushtrimit të autorizimeve të saj, Policia e Kosovës ka për detyrë të veprojë në përputhje me ligjin dhe të respektojë të drejtat e personave. Megjithatë, në raste të caktuara, veprimet ose mosveprimet e zyrtarëve policorë mund të shkaktojnë dëme materiale ose lëndime fizike të personat e prekur. Në këto situata, është e rëndësishme që personat e dëmtuar të kenë mundësinë të kërkojnë kompensim për dëmet e pësuar. Përkundër autorizimeve të gjëra që posedon Policia e Kosovës dhe ashpërsisë së tyre në kufizimin e lirive dhe të drejtave të personave, paraqet një shembull të mirë se si ka rregulluar me legjislacion por edhe në praktikë çështjen e kompensimit të dëmit.

### **V.a. Rregullimi ligjor**

Ligji për Policinë e Kosovës<sup>5</sup> në nenin 53 rregullon përgjegjësinë për dëmet ose lëndimet e shkaktuara nga zyrtarët policorë gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ky nen përcakton “1. Zyrtari policor raporton tek mbikëqyrësi i tij apo saj çdo dëm apo lëndim që ai apo ajo ka shkaktuar gjatë kryerjes së detyrave policore të tij/saj. 2. Në përputhje me ligjin në fuqi, Qeveria e Republikës së Kosovës do të jetë përgjegjëse për dëmet apo lëndimet e shkaktuara personave fizik ose juridik si rezultat i veprimeve të zyrtarëve policorë në kryerjen apo në ndërlidhje me kryerjen e detyrave policore”.

---

<sup>4</sup> Ibid

<sup>5</sup> Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës, qasshëm në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2806>

Këto dispozita përcaktojnë disa obligime dhe plotësim kushtesh ligjore për kompensimin e dëmit nga Policia e Kosovës.

Sipas paragrafit 1, zyrtari policor është i obliguar të raportojë te mbikëqyrësi çdo dëm apo lëndim që ka shkaktuar gjatë ushtrimit të detyrave policore. Kjo dispozitë vë në pah rëndësinë e transparencës dhe përgjegjshmërisë brenda strukturës policore. Detyrimi i raportimit siguron që çdo incident të dokumentohet dhe të trajtohet në përputhje me rregullat përkatëse, duke minimizuar mundësinë e fshehjes së shkeljeve ose gabimeve. Po ashtu, kjo ndihmon në nisjen e procedurave të mëtejshme administrative ose ligjore në lidhje me kompensimin e dëmit dhe kanalizimin e përgjegjësisë.

Sipas paragrafit 2, Qeveria e Republikës së Kosovës pra shteti, është përgjegjëse për dëmet ose lëndimet që i shkaktohen personave fizikë apo juridikë nga veprimet e zyrtarëve policorë gjatë kryerjes ose lidhur me kryerjen e detyrave të tyre. Ky paragraf konfirmon përgjegjësinë objektive të shtetit për veprimet e zyrtarëve të tij, edhe kur ato mund të jenë të paqëllimshme. Kjo përgjegjësi buron nga fakti se policia, si institucion publik, përfaqëson autoritetin shtetëror dhe ka detyrën të veprojë në përputhje me ligjin dhe të mbrojë interesat e qytetarëve. Prandaj edhe obligimi i kompensimit të dëmit nga shteti “justifikon” shpenzimin e parasë publike për këtë qëllim.

Përveç ligjit, ekziston një akt nënligjor i cili rregullon përgjegjësinë subjektive të zyrtarëve policor në kompensimin e dëmit. Udhëzimi administrativ Nr. 01/2012 për mënyrën e kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore<sup>6</sup> në nenin 79 përcakton përgjegjësinë për dëmet sipas të cilit “1. Zyrtari policor është i obliguar që Policisë t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar me qëllim, nga pakujdesia ose me vetëdije gjatë kryerjes së detyrës. 2. Zyrtari policor është i obliguar që Policisë t’ia kompensojë dëmin të cilin Policia duhet t’ua kompensojë qytetarit të dëmtuar ose personave juridik, që e ka shkaktuar zyrtari policor me qëllim ose nga pakujdesia me vetëdije gjatë kryerjes së detyrës. 3. Zyrtari policor është i detyruar që, menjëherë pas njoftimit, të paraqesë raportin për dëmin e shkaktuar. 4. Mënyra e kompensimit të dëmit rregullohet në përputhje me rregullat e Komisionit nga neni 15 paragrafi 2 i këtij Udhëzimi administrativ”.

Paragrafi 1., vendos përgjegjësinë subjektive të zyrtarit policor për dëmet që ai/ajo shkakton gjatë ushtrimit të detyrave të tij, kur këto dëme janë shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia me vetëdije. Pra, zyrtari duhet të mbulojë dëmin kur ka vepruar në kundërshtim me rregullat profesionale dhe ligjore.

Paragrafi 2., kjo dispozitë krijon një lidhje midis përgjegjësisë së zyrtarit policor dhe detyrimit të Policisë për të kompensuar palët e treta të dëmtuara. Në rastet kur Policia është e detyruar të paguajë një kompensim për shkak të veprimeve të qëllimshme ose të pakujdesshme të një zyrtari, ky zyrtar duhet të mbulojë këtë kompensim. Kjo dispozitë synon të mbrojë Policinë nga humbjet financiare të shkaktuara nga veprime individuale të papërshtatshme të zyrtarëve.

Paragrafi 3., kjo dispozitë vendos një detyrim të qartë procedural për zyrtarin policor që të raportojë çdo incident që rezulton në dëm. Raporti i menjëhershëm siguron që dëmi të

---

<sup>6</sup> I qasshëm në <https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2024/04/UDH%C3%8BZIM-ADMINISTRATIV-Nr.-01-2012-P%C3%8BR-M%C3%8BNYR%C3%8BN-E-KRYERJES-S%C3%8B-DETYRAVE-DHE-AUTORIZIMEVE-POLICORE.pdf>



dokumentohet në kohë, duke mundësuar hetimin dhe trajtimin e rastit sipas rregullave të brendshme. Ky detyrim rrit transparencën dhe ndihmon në përmirësimin e përgjegjshmërisë brenda strukturës policore.

Paragrafi 4., bën referencë tek komision të posaçëm, i cili themelohet sipas nenit 15 paragrafi 2 i këtij Udhëzimi administrativ dhe është përgjegjës për rregullimin dhe përcaktimin e mënyrës së kompensimit të dëmit. Ky komision vepron në përputhje me rregullat e përcaktuara në udhëzimin administrativ përkatës, duke siguruar që procesi të jetë i drejtë dhe i bazuar në parime të qarta ligjore. Komisioni luan një rol kryesor në vlerësimin e përgjegjësisë dhe përcaktimin e masës dhe formës së kompensimit.

Siç mund të kuptohet korniza ligjore në Policinë e Kosovës është mjaftë e qartë dhe e plotë duke vendosur rregulla për kompensimin e dëmit personave por edhe përgjegjësinë objektive të shtetit dhe përgjegjësinë subjektive të zyrtarit policor kur të njëjtit shkaktajnë dëme gjatë ushtrimit të autorizimeve policore.

#### **IV.b. Si bëhet në praktikë kompensimi i dëmit**

Përveç akteve ligjore që u trajtuan më lartë, Policia e Kosovës ka një rregullore të posaçme që rregullon çështjen e kompensimit të dëmit të shkaktuar gjatë ushtrimit të autorizimeve policore. Neni 26 të Rregullores për personel dhe administratë në Policinë e Kosovës<sup>7</sup> mjaft mirë rregullon realizimin praktik të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga Policia e Kosovës. Fillimisht trajtohet mundësia që Policia e Kosovës, gjatë kryerjes së detyrave policore në zbatim të ligjit, mund të shkaktojë dëme materiale personave të tretë që nuk janë subjekt apo cak i operacioneve policore dhe që nuk janë fajtorë për dëmin e shkaktuar. Ky dëm duhet të kompensohet në mënyrë të drejtë dhe proporcionale. Procedura fillon sipas detyrës zyrtare me detyrimin e zyrtarit policor që ka shkaktuar dëmin që të raportojë rastin sa më shpejt të jetë e mundshme të mbikëqyrësi i tij përmes një raporti të detajuar me shkrim. Në raport duhet të përshkruhen në detaje rrethanat e rastit, dëmet e shkaktuara, si dhe dëshmitë mbështetëse, të tilla si fotografite dhe dokumentet përkatëse. Raporti duhet të jetë i saktë dhe gjithëpërfshirës për të lehtësuar hetimin dhe trajtimin e rastit.

Mbikëqyrësi, pas shqyrtimit të raportit, ka përgjegjësinë të vërtetojë nëse dëmi është rezultat i detyrave zyrtare dhe në përputhje me rregulloret policore. Ai e përcjell raportin me rekomandimet e tij komandantit të stacionit për shqyrtim të mëtejshëm. Komandanti, pas pranimit të raportit, ia përcjell atë Drejtorisë Rajonale të Policisë, duke përfshirë të gjitha provat dhe dokumentet e mbledhura deri në atë pikë. Drejtoria Rajonale më pas njofton Drejtorinë për Hetime të Brendshme (DHB) dhe ia dorëzon dosjen e plotë për shqyrtim dhe hetim të mëtejshëm.

DHB shqyrton rastin duke analizuar rrethanat dhe provat e paraqitura. Në përfundim të shqyrtimit, DHB harton një raport mbi të gjeturat dhe ia dërgon Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm për Resurse. Nëse DHB konstaton se ka pasur shkelje nga zyrtari policor, mund të rekomandojë masa disiplinore apo edhe iniciimin e procedurës penale nëse ka elemente të veprës penale, bazuar në rëndësinë e shkeljes dhe dëmin e shkaktuar. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm për

---

<sup>7</sup> Rregullorja për personel dhe administratë në Policinë e Kosovës, e qasshme në linkun: <https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2020/07/1.-Rregullorja-e-Personel-dhe-Administrat%C3%88.pdf>

Resurse, pas pranimit të raportit dhe rekomandimeve nga DHB, formon një komision për vlerësimin e dëmit.

Komisioni për vlerësimin e dëmit përbëhet nga tre anëtarë dhe ka për detyrë të analizojë dosjen dhe të vlerësojë dëmin në mënyrë të drejtë dhe transparente. Komisioni duhet të shqyrtojë të gjitha provat, duke përfshirë raportet zyrtare, fotografitë, dëshmitë dhe çdo dokument tjetër mbështetës. Në përfundim të shqyrtimit, komisioni kthen raportin e tij te Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm për Resurse për marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me kompensimin e dëmit. Vendimi merret bazuar në nenin 53 të Ligjit për Policinë e Kosovës dhe duhet të adresojë qartë mënyrën dhe shumën e kompensimit për dëmin e shkaktuar.

**Figura 1. Procesi i kompensimit të dëmit në Policinë e Kosovës**



Në rastet kur hetimi zbulon se veprimet e zyrtarit policor janë kryer në kundërshtim me rregullat dhe procedurat e Policisë apo Kodin e Sjelljes, mund të iniciohet procedura disiplinore dhe mund të shqiptohen masa ndaj zyrtarit policor që ka shkaktuar dëmin. Përveç masave disiplinore, mund të iniciohet edhe procedurë penale kur shkella konsiderohet e rëndë dhe përbën veprë penale.

Në rastet kur lënda përfshin edhe procedurë penale, dosja e dëmit i bashkëngjitet rastit për shqyrtim nga gjykata. Gjkata, në bazë të provave dhe pretendimeve të palëve, vendos për kompensimin e dëmit nëse pala e dëmtuar paraqet një kërkesë të tillë. Vendimi i gjykatës duhet të jetë i bazuar në parimet e drejtësisë dhe proporcionalitetit, duke siguruar që pala e dëmtuar të marrë kompensimin e duhur dhe të plotë për dëmin e shkaktuar. Ky proces siguron që të gjitha rastet e dëmit të trajtohen me seriozitet dhe në përputhje me standardet ligjore dhe etike të Policisë së Kosovës.

#### **IV. Kompensimi i dëmit nga inspektoratet**

Kompensimi i dëmit nga inspektoratet është një mekanizëm i rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të personave, kur veprimet ose mosveprimet e inspektoratit shkaktojnë dëme gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Inspektoratet, si organe publike me autorizime specifike për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit, kanë detyrimin të veprojnë me kujdes dhe profesionalizëm. Megjithatë, në disa raste, veprimet e tyre mund të jenë të gabuara, të pajustificueshme ose të tejkalojnë kompetencat ligjore, duke shkaktuar dëme financiare, materiale ose morale ndaj palëve të prekura. Në raste të tilla, kompensimi i dëmit është një mjet për të siguruar drejtësi dhe për të rivendosur gjendjen e mëparshme për të dëmtuarit.

Përgjegjësia për dëmin nga inspektoratet mbështetet në parimin e shtetit të së drejtës, i cili kërkon që çdo veprim i një organi publik të jetë në përputhje me ligjin dhe që shteti të mbajë përgjegjësi për dëmet që rrjedhin nga keqpërdorimi i autoritetit publik. Ky parim përfshin edhe detyrimin e inspektorateve për të kompensuar dëmet që rrjedhin nga veprime të paligjshme, si vendime administrative të gabuara, gjoba të paarsyeshme ose ndalime të aktivitetit të cilat më vonë mund të rezultojnë të pabazuara. Për më tepër, në raste të caktuara, kur veprimet e një inspektorati janë të qëllimshme ose rezultat i pakujdesisë me vetëdije, përgjegjësia mund të kalojë edhe tek inspektorët brenda institucionit që kanë shkaktuar dëmin.

#### IV.a. Rregullimi ligjor

Ligji Nr. 08/L-067 për Inspektimet<sup>8</sup> në Kosovë përcakton parimet dhe procedurat për funksionimin e inspektorateve, duke synuar mbrojtjen e interesit publik, përfshirë shëndetin publik, sigurinë publike dhe mjedisin. Megjithatë, ky ligj nuk përmban dispozita specifike që rregullojnë drejtpërdrejt kompensimin e dëmeve materiale të shkaktuara nga veprimet ose mosveprimet e inspektorateve gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

Neni 50 i Ligjit për inspektimet rregullon përgjegjësinë për dëmet që shkaktohen nga organet inspektuese “Përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga organet inspektuese dhe inspektorët rregullohet sipas legjislacionit në fuqi”. Kjo dispozitë trajton çështjet e përgjegjësive dhe kompensimit të dëmeve të shkaktuara gjatë procesit të inspektimit. Pra, në rastet kur veprimet ose mosveprimet e inspektorëve gjatë ushtrimit të detyrave të tyre shkaktojnë dëme materiale ose jomateriale ndaj subjekteve të inspektimit apo palëve të treta, përgjegjësia për kompensimin e këtyre dëmeve bie mbi organin inspektues përkatës. Me këtë sigurohet që subjektet e inspektimit dhe palët e treta të kenë mundësinë të kërkojnë kompensim për dëmet e pësuar si rezultat i veprimeve të inspektorëve. Nga ky rregullim mund të kuptojmë vetëm përgjegjësinë objektive të organeve inspektuese por jo edhe përgjegjësinë subjektive të inspektorëve të cilët kanë shkaktuar dëmin. Meqenëse kjo nuk rregullohet edhe me Ligjin Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik në kuadër të të drejtave dhe detyrave që ata i kanë së nëpunës civil, për përgjegjësinë subjektive në shkaktimin e dëmit nga inspektorët mund të zbatohen dispozitat e përgjithshme të ligjit Nr. 03/L-212 të punës<sup>9</sup>. Neni 64 i ligjit të punës rregullon përgjegjësinë e punëtorëve ndaj punëdhënësit për dëmet e shkaktuara me qëllim ose nga pakujdesia gjatë kryerjes së detyrave të punës. Në kontekstin e inspektoratit, kjo dispozitë vë përgjegjësi individuale mbi inspektorin që ka shkaktuar dëm, nëse dëmi është rezultat i veprimeve të tij të qëllimshme ose të pakujdesishme. Për shembull, një inspektor që vepron jashtë kompetencave të tij dhe shkakton dëme materiale ose morale mund të mbahet personalisht përgjegjës për të kompensuar dëmin ndaj organit të punësimit (inspektoratit). Ndërsa, neni 65 i ligjit të punës, përcakton detyrimin e punëdhënësit për të kompensuar dëmin e shkaktuar nga punëtori i tij ndaj palëve të treta gjatë kryerjes së detyrave të punës. Kjo dispozitë mbështet parimin e përgjegjësive objektive të inspektoratit, duke e detyruar atë të kompensojë dëmet që inspektorët e tij mund të shkaktojnë

---

<sup>8</sup> I qasshëm në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53067>

<sup>9</sup> I qasshëm në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

ndaj subjekteve të inspektimit ose palëve të tjera gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare. Pra neni 65 është i ngjashëm me nenin 50 të ligjit të inspektimeve, pra rregullojnë përgjegjësinë objektive në kompensimin e dëmit.

Ligji i inspektimeve edhe pse rregullon kompensimin e dëmeve që shkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë inspektuese referenca në legjislacionin në fuqi është një mangësi dhe në praktikë nuk mund të zbatohet. Kjo për shkakun se Republika e Kosovës nuk ka ligj horizontal që rregullon në mënyrë të plotë përgjegjësinë e administratës publike për t'i kompensuar dëmet që shkaktohen gjatë veprimtarisë administrative duke përfshirë edhe atë inspektuese. Një mungesë e tillë ekziston edhe tek ligjet e veçanta që rregullojnë inspektimet, pra nuk rregulla specifike se si bëhet kompensimi i dëmit që mund të shkaktohet nga mbikëqyrja inspektuese. Në mungesë të dispozitave specifike, çështjet që lidhen me kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga inspektoratet trajtohen në përputhje me legjislacionin e përgjithshëm të Kosovës që rregullon përgjegjësinë civile. Këtu përfshihet Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve<sup>10</sup> i cili përcakton parimet dhe procedurat për kompensimin e dëmit.

## V. Kompensimi i dëmit në nivel gjyqësor

Si institut juridik, kompensimi i dëmit i takon të drejtës private që nënkupton se nëse nuk bëhet me marrëveshje në mes palëve atëherë mund t'i drejtohem gjykatës (zakonisht asaj civile) me padi për të kompensuar dëmin,

Në Republikën e Kosovës, personat kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar kompensim për dëmet e shkaktuara nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të administratës publike. Kjo e drejtë mbështetet si në Kushtetutë<sup>11</sup> por së fundmi edhe në Ligjin për Konfliktet Administrative.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën e individëve për mbrojtje gjyqësore të të drejtave. Neni 32 i Kushtetutës parasheh të drejtën në mjete juridike "Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj". Kjo dispozitë kushtetuese garanton të drejtën e çdo personi për të përdorur mjete juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative që cenojnë të drejtat ose interesat e tij. Kjo krijon një bazë të fortë për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave, duke siguruar që asnjë vendim që prek padrejtësisht personat fizik dhe juridik të mbetet arbitrar dhe i pa kontestuar. Në kontekstin e kompensimit të dëmit, ky nen siguron të drejtën për të kërkuar drejtësi dhe rivendosjen e gjendjes së mëparshme përmes mekanizmave të përcaktuara me ligj. Përmes kësaj dispozite, qytetarët mund të kërkojnë kompensim për dëmet e shkaktuara nga veprime ose mosveprime të paligjshme të organeve administrative. Kjo përfshin të drejtën për të paraqitur ankesë administrative dhe, nëse është e nevojshme, të ndjekin rrugën gjyqësore për të siguruar një vendim të drejtë dhe të paanshëm. Nëse një organ administrativ ka marrë një vendim që shkakton dëme materiale ose jomateriale, individët kanë të drejtë të kërkojnë anulimin e vendimit dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar, duke ndjekur procedurat e përcaktuara në

---

<sup>10</sup> Ligji Nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, i qasshëm në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2828>

<sup>11</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e qasshme në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Ligjin për Konfliktet Administrative. Gjykata administrative në këtë rast shqyrton pretendimet e palëve dhe vendos për vlefshmërinë e padisë për kompensim e dëmit, duke zbatuar standardet kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen e të drejtave. Kështu, Neni 32 siguron një mjet të rëndësishëm për mbrojtjen kushtetuese të personave ndaj abuzimeve administrative dhe për garantimin e një procesi të drejtë për kompensimin e dëmeve.

Ligji Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative<sup>12</sup> bën një rregullim substancial sa i përket kompensimit të dëmit personave të shkaktuar nga administrata publike gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative. Fillimisht, ky ligj bën një dallim në mes drejtës publike dhe asaj private duke parashikuar juridiksionin e gjykatës administrative për të gjykuar në lidhje me kontestet për kompensimin e dëmit ku palë është administrata publike dhe duke parashikuar edhe padi të veçantë e cila mund të ngritët nga personat sa herë që kanë pas dëm nga organet e administratës publike.

Ky ligj përcakton se personat që pretendojnë se janë dëmtuar nga aktet administrative kanë të drejtë të ngrenë padi në gjykatën kompetente për të kërkuar anulimin e aktit dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar. Procedura fillon me paraqitjen e padisë në gjykatën kompetente brenda afateve të përcaktuara ligjore, ku paditësi duhet të paraqesë prova që mbështesin pretendimet e tij për dëmin e pësuar.

Padia për kompensimin e dëmit sipas Ligjit Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative përfaqëson një mjet juridik të rëndësishëm për personat që kërkojnë mbrojtje dhe dëmshpërblim për dëmet e shkaktuara nga veprimet ose mosveprimet e organeve publike. Ky ligj siguron një kornizë të qartë për të adresuar pretendimet për dëme që lindin nga aktet administrative të paligjshme ose nga veprime që tejkalojnë kompetencat ligjore të autoriteteve publike. Në raste të tilla, personi i dëmtuar ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatën kompetente për të kërkuar kompensimin e dëmit të pësuar.

Procesi përfshin paraqitjen e një padie që argumenton natyrën e dëmit dhe lidhjen shkakësore midis veprimeve administrative dhe dëmit të shkaktuar. Paditësi duhet të respektojë afatet kohore të përcaktuara nga ligji dhe të paraqesë prova që mbështesin pretendimet e tij, si akte administrative, dëshmi të dëmit material apo jomaterial, dhe fakte që tregojnë paligjshmërinë e veprimit ose mosveprimit administrativ. Gjykata shqyrton padinë duke analizuar bazueshmërinë ligjore dhe faktike të rastit, dhe nëse konstaton se paditësi ka të drejtë, vendos për kompensimin e dëmit.

Ligji synon të garantojë një balancë midis mbrojtjes së të drejtave të individëve dhe ruajtjes së funksionalitetit të administratës publike. Duke mundësuar kompensimin e dëmit përmes rrugës gjyqësore, ai forcon parimin e shtetit të së drejtës dhe ofron një mekanizëm për të parandaluar dhe adresuar abuzimet administrative. Në këtë mënyrë, Ligji për Konfliktet Administrative jo vetëm që mbron të drejtat e qytetarëve, por edhe nxit përgjegjshmërinë e administratës publike në mënyrë që veprimet që kanë shkaktuar dëme të mos përsëriten.

## VI. Konkluzione dhe rekomandime

---

<sup>12</sup> Ky ligj hyn në në janar të vitit 2025, l qasshëm në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85181>

## Konkluzione

1. Përgjegjësia e administratës publike për kompensimin e dëmeve është një shtyllë thelbësore e administrimit të mirë dhe e shtetit demokratik, duke reflektuar parimin e sundimit të ligjit dhe të drejtave të qytetarëve.
2. Megjithëse Kushtetuta, Ligji i Policisë, Ligji i inspektimeve, Ligji për Konfliktet Administrative dhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ofrojnë një bazë ligjore për kompensimin e dëmeve, zbatimi praktik mbetet i kufizuar për shkak të mungesës së një ligji horizontal që rregullon përgjegjësinë e administratës publike në mënyrë të detajuar dhe koherente.
3. Përgjegjësia e inspektorateve për dëmet e shkaktuara gjatë inspektimeve nuk është rregulluar në mënyrë specifike, duke krijuar pasiguri juridike dhe sfida praktike për trajtimin e këtyre rasteve. Për pasojë, e vetmja rrugë e kompensimit të dëmit mbetet ajo gjyqësore.
4. Korniza ligjore për Policinë e Kosovës është e avancuar, duke përfshirë përgjegjësinë objektive të shtetit dhe atë subjektive të zyrtarëve policorë. Megjithatë, procedurat e brendshme burokratike dhe komplekse mund të zgjasin procesin e kompensimit në mënyrë efikase dhe të shpejtë.
5. Ligji për Konfliktet Administrative, që hyn në fuqi në vitin 2025, përmirëson dukshëm terrenin ligjor për kompensim të dëmeve administrative, duke krijuar mundësi për ngritjen e padive specifike për këtë qëllim.

## Rekomandime

1. Vendosja e kornizës ligjore për kompensimin e dëmit në nivel të administratës publike ku mund të konsiderohen këto opsione”
  - a) *Opsioni 1*, hartimi i një ligji të posaçëm horizontal për përgjegjësinë jashtëkontraktore të administratës publike për kompensimin e dëmeve, ose
  - b) *Opsioni 2*, plotësimi dhe ndryshimi i ligjeve të veçanta për të rregulluar kompensimin e dëmit në nivel të administratës publike.

Cilido opSION që konsiderohet, duhet të përcaktojë qartë standardet për përgjegjësinë objektive dhe subjektive të organeve publike dhe të sigurojë procedura të thjeshta dhe efektive për kompensimin e dëmeve.

2. Rishikimi i Ligjit për Inspektimet për të përfshirë dispozita specifike që rregullojnë në mënyrë të detajuar përgjegjësinë për dëmet që shkaktojnë inspektorët dhe organet inspektuese, duke përfshirë kriteret për vlerësimin e dëmeve dhe procedurat për kompensim.
3. Trajnimi i stafit administrativ dhe zyrtarëve publikë për të kuptuar më mirë detyrimet e tyre dhe për të parandaluar gabimet që mund të çojnë në dëme, si dhe për të siguruar zbatimin efektiv të procedurave të kompensimit.
4. Fuqizimi i mekanizmave për kompensimin e dëmeve brenda institucioneve publike për të trajtuar kërkesat për kompensim me shpejtësi dhe transparencë, duke reduktuar nevojën për procedura gjyqësore të gjata dhe të kushtueshme.
5. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat e tyre në lidhje me kompensimin e dëmeve nga administrata publike, përmes fushatave informuese dhe qasjes së lehtësuar në informacion.
6. Zbatimi efektiv i Ligjit për Konfliktet Administrative duke garantuar që gjykatat administrative të jenë të pajisura me burime të mjaftueshme për të trajtuar paditë për kompensim në mënyrë efikase dhe të drejtë.
7. Monitorimi i rasteve të kompensimit për të identifikuar mangësitë sistematike dhe për të ndërmarrë hapa të nevojshëm për përmirësimin e politikave dhe rregullave ligjore.





Funded by  
the European Union



GROUP FOR LEGAL  
AND POLITICAL  
STUDIES